



Pranuar / Dorezuar Puneheni/Prodato Received/Delivered	15.06.2022	2	viti god year
Organ /Bjesta Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKNSHCK	3493/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.462/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.462/2022 të datës 18.05.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi në [redacted] kundër Vendimit KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 15.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.462/2022 e datës 18.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anullohet Vendimi KD.Nr.020-/2022 i datës 15.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 18.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër

Vendimit KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 30.05.2022 ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2885/2022 të datës 18.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Emailin e datës 18.05.2022 të ankuesit; Përshkrimin e punës Mbikëqyrësi të Lartë/Përgjegjës i Pavijonit; Kërkesën për përgjigje në ankesë 25.05.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 30.05.2022; Ndryshmi dhe Plotësimi i kontratës i datës 1305.2019 për ankuesin; Kontratë Punë për kohë të caktuar e datës 01.11.2018; Inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 16.03.2022; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 10.03.2022; Fletë kthesen e datës 19.04.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 06.04.2022; Vendimin me Nr. 747 i datës 08.10.2019 për formimin e Komisionit Profesional; Raporti Përfundimtar i Hetimeve me Nr.0115 i datës 07.02.2022; Vendimin me Nr.0089 i datës 31.01.2022 për formimin e Komisionit të brendshëm hetimor; Kërkesën për ekzekutimin e dënimit me Nr.326 e datës 19.05.2021; Aktgjykimin PS 54/20 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special; Aktgjykimin APS.nr.1/21 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special; Shkresën për llogaritjen e dënimit e datës 21.03.2022; Formularin e vlerësimit për beneficione Ref. 4.4 i datës 16.03.2021; Kërkesën me numwr protokolli 901 e datës 12.03.2021; Formen e Panelit për Beneficione Ref.4.4.1 e datës 16.03.2021; Formularin e vlerësimit për beneficione Ref.4.4 e datës 19.03.2022; Raportin për pushim jashtë burgut i datës 22.03.2021 dhe 19.03.2021; Kërkesën me numwr protokolli 941 e datës 17.03.2021; Certifikatëne martesës e datës 16.03.2021; Formwn e Panelit për beneficione Ref.4.4.1 e datës 22.03.2021; Shkresën për rivlerësim për beneficione Ref. 4.1.5 e datës 30.04.2021; Kërkesën me Nr.Protokol: 1470 e datës 29.04.2021; Forma e Panelit për Beneficine Forma 4.1.4/1 e datës 11.05.2021; Shkresën për rivlerësim për beneficione Ref.4.1.5 e datës 28.06.2021; Kërkesë me me numwr protokolli 2142 e datës 21.06.2021; Formular i Panelit për beneficione Forma.4.1.4/1 e datës 29.06.2021; Shkresë për rivlerësim për beneficione Ref.4.1.5 e datës 28.09.2021; Kërkesën e datës 28.09.2021; Formularin e Panelit për beneficione Forma.4.1.4/1 e datës 28.09.2021; Vendimin e datës 27.10.2020; Njoftimin e datës 23.03.2021, 25.05.2021, 21.07.2021, 28.09.2021; Shkresën e datës 24.03.2021, 25.05.2021 dhe 21.07.2021; Vendimin me Nr.1187 i datës 20.10.2021 për themelim të Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr.0139 i datës 10.02.2022 për themelim të Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 12.01.2016 për themelimin e Komisionit Disiplinor dhe Propozimin për masën disiplinore i datës 19.01.2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi sipas ndryshimit dhe plotësimit të Kontratës së Punës të datës 13.05.2019 është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës *Mbikëqyrës i Lartë* në Burgun e Sigurisë së Lartë. Bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor me numër protokolli 0115 të datës 07.02.2022, kryesuesi i Komisionit Disiplinor me datë 10.03.2022 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit me pretendimin se sipas të gjeturave nga Raporti Hetimor ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrës së punës pasi që i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me Vendimin KD.nr.020-/2022 të datës 15.04.2022, ka konstatuar së ankuesi në cilësinë e anëtarit të Panelit për Benificione ka aprovuar tri kërkesa të të dënuarit F.M për befinicione (qëndrim në lokale të veçanta me bashkëshorten) në kundërshtim me dispozita e Udhëzimit Administrativ MD nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues, duke e shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe 3.10 lidhur me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 48 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues, dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar masën disiplinore *"ndalimi 20% i pagës për periudhën prej një muaj"* sipas nenit 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi kundër Vendimit KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ky vendim është i padrejtë dhe se masa disiplinore nuk është shqiptuar në proporcion me shkeljen e supozuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sipas detyrës zyrtare/ex officio ka analizuar respektimin e dispozitave thelbësore procedurale lidhur me këtë çështja administrative dhe rrjedhimisht nga analizimi i provave materiale ka konstatuar së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit me Vendimin më numër protokolli 1187 të datës 20.10.2021 ka themeluar Komisionin Disiplinor me mandat tre vjeçar, ndërsa me datë 11.02.2022 pra tri ditë pas Raportit Hetimor të datës 07.02.2022, ka ndryshuar në tërësi përbërjen e anëtarëve të këtij komisioni duke themeluar Komision të ri Disiplinor sipas Vendimit me numër protokolli 0139 të datës 11.02.2022, pa dhënë ndonjë arsytim se për cilat shkaqe bëhet ndryshimi i përbërjes së Komisionit Disiplinor, kështu që një veprim i tillë gjegjësisht ndryshimi i përbërjes së Komisionit Disiplinor sipas rasteve, krijon pasiguri juridike për nëpunësit civil në kuadër të Shërbimit Korrektues dhe si i tillë është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin parashihet se: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj....*

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar së anëtari i Komisionit Disiplinor nuk ka shpërfaqur konfliktin e interesit në procedurën disiplinore ndaj ankueset, sepse nga vlerësimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas



Vendimit të datës 12.01.2016 ka qenë i emëruar anëtar i Komisionit Disiplinor për Drejtorinë e Burgut të Sigurisë së Lart, dhe së i njëjti me datë 19.01.2016 kishte vendos në procedurë disiplinore të filluar ndaj [redacted] duke propozuar shqiptimin e masës disiplinore "qortim me vërejtje me shkrim", Andaj, Kolegji vlerësoj së nxjerrja e vendimit të goditur me ankesë, mbi bazën e ekzistimit të këtyre rrethanave të konfliktit të interesit është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji vlerëson së Vendimi KD.Nr.020-/2022 i datës 15.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës është i përfshirë më të meta të atilla që pengojnë vendosjen në mënyrë meritore lidhur me këtë çështja, kështu që organi i punësimit gjegjësisht Komisioni Disiplinor në riprocedurë duhet të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi, dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Nisur si me lartë, Kolegji pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.462/2022

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.